



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 674/1 Prot

Tiranë, më 24/7/2015

Lënda: *Jepet mendim mbi projektligjin "Për Mbrojtjen e sinjalizuesve"*

Drejtuar: **Z. Bledar ÇUÇI**
MINISTËR PËR ÇËSHTJET VENDORE

Tiranë

I nderuar Z.Çuçi,

Mbrojtja e privatësisë dhe e drejta për informim janë elementë bazë dhe të pacënueshëm të parashikuar në Kushtetutën e vendit, në akte ndërkombëtare dhe njëkohësisht kërkojnë gjithë vëmendjen e duhur që të gjejnë zbatim në legjislacionin kombëtar.

Balancimi i këtyre të drejtave me informacionet që do të sinjalizohen do të lejonte rregullsi në këto procese apo edhe do të frenonte dëshirën për të dhënë informacione të rremë.

Grupi i Punës i krijuar në bazë të nenit 29 dhe 30 (1) (c) dhe (3), të Direktivës 95/46/EC, është shprehur me **Opinionin 1/2006 (miratuar në 1 shkurt 2006) "Për zbatimin e rregullave të mbrojtjes së të dhënave të BE-së, për skemat e bilbilfryrësve në fushat e llogarive, kontrolleve të llogarive të brendshme, çështjet e auditimit, çështjet bankare dhe kimit financiar dhe luftën kundër ryshfetit"**.

Kjo skemë sipas këtij opinionioni duhet të shihet si degë për institucionin, dhe jo një zëvendësim për menaxhimin e brendshëm.

Megjithë akuzat e hedhura ndaj një individi shprehet opinionin, ai gëzon të drejtat e parashikuara në Direktivën 95/46 / EC, si dhe dispozitave korresponduese në ligjin kombëtar.

Opinionin kërkon *nxitje të raportimeve të identifikuar dhe jo konfidenciale, ndaj raportimeve anonime.*

Opinionin kërkon arritjen e një ekuilibri në mes të interesave legjitime të kontrolluesit që do të përpunojë të dhënat në këtë rast dhe të drejtave themelore të subjekteve të të dhënave/të sinjalizuarve. (Neni 7 (f))

Opinionin kërkon që të dhënat personale të përpunuara nga një skemë sinjalizimi duhet të fshihen menjëherë dhe zakonisht brenda dy muajve të përfundimit të hetimit të fakteve të dyshuar në një raportim.

Opinionin kërkon përcaktimin e saktë të periudhës së mbajtjes së të dhënave. Ato do të duhet të jenë të ndryshme, kur procedura ligjore ose masa disiplinore janë iniciuar kundër personit të inkriminuar ose për sinjalizuesin në rastet e dhënies së informacionit të rremë ose bërjes së

deklaratës shpifëse. Në raste të tilla, të dhënat personale duhet të mbahen deri në përfundim të këtyre procedurave dhe periudhës së lejuar për çdo ankesë.

Opinionit kërkon të parashikohen rregulla kombëtare në lidhje me arkivimin e të dhënave.

Opinionit shprehet se, i raportuari ose thënë ndryshe i akuzuari, ka të drejtat e tij.

Anonimiteti shprehet Opinioni, nuk mund të jetë një zgjidhje e mirë për sinjalizuesit pasi si i tillë ai nuk ndalet për të bërë sukses dhe ngjallur ose ringjallur shqetësime.

- Raportet anonime, shprehet Opinioni, mund të çojnë njerëzit të përqëndrohen tek sinjalizuesit.
- Gjithashtu, do të zhvillohet kështu një kulturë e pranimit anonim e raporteve keqdashës.
- Klima sociale brenda institucionit mund të përkeqësohet nëse punonjësit janë të vetëdijshëm se raportet anonime në lidhje me ato mund të paraqiten përmes skemës në çdo kohë.
- Sipas Opinioni, kjo lloj skeme (anonim) të ngrihet si një përjashtim nga rregulli pa inkurajuar raportimin anonim si mënyrë e zakonshme për të bërë një ankesë.

- Të drejtat e personit të sinjalizuar

Opinionit shprehet për të drejtat e personit të sinjalizuar. Opinioni kërkon zbatimin e nenit 11 të Direktivës 95/46 / EC me qëllim që individët të jenë të informuar kur të dhënat personale janë mbledhur nga një palë e tretë dhe jo nga ata direkt.

Personi i akuzuar në raportin e një sinjalizuesi duhet të informohet nga personi i ngarkuar i skemës sa më shpejt të jetë e mundur, pasi të dhënat e lidhura me të janë regjistruar. Opinioni shprehet se, sipas nenit 14 të Direktivës edhe ata kanë të drejtën për të kundërshtuar përpunimin e tyre në rast se provohet që përpunimi i të dhënave është kryer në kundërshtim me nenin 7/f të Direktivës.

Në veçanti, i sinjalizuari duhet të jetë i informuar në lidhje me 1) subjektin përgjegjës të skemës së hetimit të sinjalizimit, 2) faktet mbi të cilat ai është akuzuar, 3) departamentet ose shërbime të cilat mund të marrin raportin brenda kompanisë së tij ose në subjekte të tjera, ose në kompanitë e grupit pjesë e të cilës është kompania, si dhe 4) për të ushtruar të drejtat e tij mbi aksesin dhe kërkimin e korrigjimit.

Opinionit shprehet se, nëse paraqitet rrezik real, i konsiderueshëm duke dhënë informacion nga skema e hetimit, me qëllim për të hetuar në mënyrë efektive, njoftimi për individin mund të shtyhet për aq kohë sa një rrezik i tillë ekziston. Ky përjashtim nga rregulli i parashikuar në nenin 11 të Direktivës synon të ruajë provat, duke parandaluar shkatërrimin e tyre ose ndryshim nga personi i sinjalizuar.

- Përputhja me kërkesat e njoftimit

Veprimet e përpunimit të të dhënave shprehet Opinioni mund të jenë subjekt i kontrollit paraprak nga autoriteti kombëtar për mbrojtjen e të dhënave për më shumë kur ato kanë të ngjarë të paraqesin një rrezik të veçantë për të drejtat dhe liritë e subjekteve.

Në këtë këndvështrim, p/ligji duhet të reflektojë sugjerimet e mëposhtme.

- Krijimi i skemës së sinjalizuesve duhet të bëhet në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale, siç parashikohet në Direktivën 95/46 / EC, **rrjedhojë e të cilës është ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.**
- Në fushën e zbatimit të këtij p/ligji të përfshihet fakti se zbatimi i një skeme të tillë nuk përjashton të sinjalizuarit nga të drejtat e tyre të parashikuara në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, ose duke shtuar pas parashikimit aktual togfjalëshin “...pa cënuar të drejtat e të sinjalizuarit lidhur me përpunimin e të dhënave të tij personale”.

- Për rrjedhojë të parashikohet në p/ligj përkufizimi i “të sinjalizuarit”.
- Në Qëllimin e parashikuar në këtë p/ligj të përfshihet edhe mbrojtja e individëve të akuzuar të cilët deri në përfundim të një procesi prezumohen të pafajshëm.(p.sh të shtohet “pa cënuar të drejtat themelore dhe liritë e subjektit të të dhënave”).
- Sinjalizuesi të mbetet anonim për arsye legjitime të forta. Kjo do të jepte impakt pozitiv në funksionimin e kësaj skeme dhe në çdo moment nuk do të krijonte një zinxhir anonimiteti i cili krijohet nëse ka zanafillën anonim.
- Në p/ligj të parashikohet detyrimi i skemës për të informuar të sinjalizuarin.
- Në p/ligj të parashikohet koha e mbajtjes së të dhënave.
- Në p/ligj të parashikohen rregulla në lidhje me arkivimin e të dhënave.
- Në p/ligj duhet të hiqet parashikimi i cili përfshin në rrethin e sinjalizuesve edhe ish të punësuarit.
- Në përpunimin e të dhënave përfshihet skema e hetimit por edhe sinjalizuesi. Ligji për mbrojtjen e të dhënave e ka zgjidhur sanksionimin e skemës së hetimit në rast të shkeljeve të konstatuara për përpunimin e të dhënave, ndërsa nuk mund të sanksionojë sinjalizuesin. Kjo kërkon ndryshime ligjore.
- Të parashikohet në p/ligj mbajtja e raportimit anonim vetëm në rast të shfaqjes së një rreziku real, deri në konstatimin e zhdukjes së tij.
- Neni 28 i p/ligjit duhet rishikuar pasi nuk është rezultat i nenit 1 të këtij p/ligji, siç parashikohet.

Gjithashtu, lidhur me parimin e konfidencialitetit të parashikuar në nenin 4 të projektligjit, sugjerojmë që personeli me akses në informacion të ruajë konfidencialitetin dhe besueshmërinë e informacionit të përpunuar gjatë ushtrimit të funksionit por edhe pas përfundimit të tij, nëpërmjet nënshkrimit të një akti, (p.sh deklaratë konfidencialiteti).

Për sa më sipër, p/ligji kërkon një rishikim të plotë përsa i përket garantimit të të drejtës kushtetuese të mbrojtjes së të dhënave të personit.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.

